



2  
0  
2  
4

# BULETINI

---

## QERSHOR



## ***Nderohet me homazhe martiri Uran Amërlahu***

*Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, në nderim të 25-vjetorit të rënies së nxënësit të shkollës filllore "Ibrahim Banushi" në Shalë, Uran Amërlahu, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule në shenjë përkujtimi pranë pllakës përkujtimore të Uranit, i cili u vra nga forcat serbe në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve në Grykën e Shalës.*

*"Ky nderim tregon përkushtimin tonë institucional për të mos harruar të kaluarën dhe për të vlerësuar lartë veprat e atyre që kanë dhënë jetën për liri. Tregon qartë se lirinë nuk e kemi fituar lehtë, për të cilën kemi sakrifikuar shumë për të arritur deri këtu ku jemi", ka thënë Kryetari Ahmeti*

*Lavdi gjithë martirëve!*



## **1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve**

*Në sheshin “Adem Jashari”, me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, po shënohet Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve me aktivitete të shumta dhe festive. Në sheshin e qytetit të Lipjanit po zhvillohen aktivitete të ndryshme që synojnë ta bëjnë këtë ditë sa më të veçantë.*



## ***Komuna e Lipjanit përfituese nga Granti i Përfomances për Mjedis të Pastër***

***Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me drejtorin e shërbimeve publike, mbrojtje dhe shpëtim z. Burim Rrustemi, në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, kanë pranuar donacion 117 Kontejnerë metalik 1.1m<sup>3</sup> dhe 1100 Kontejner plastik 120 L, në kuadër të skemës nga Gara për Mjedis të Pastër dhe Granti i Përfomancës Komunale nga MMPHI, ku Komuna e Lipjanit është përfituese edhe në këtë vit.***

***Nënkryetari Bytyqi, gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshje, ka theksuar se këto pajisje do të jenë në shërbim të qytetarëve lipjanas por edhe një lehtësim në grumbullimin e mbeturinave nga njësisia operative e Pastrimit në Lipjan.***



## ***Nderohet me homazhe Heroi Lulzim Llugiqi***

***Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Lipjanit, z. Daut Azemi, së bashku me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit Lulzim Llugiqi, me rastin e 25-vjetorit të rënies së tij.***

***Me këtë rast, kryesuesi Azemi theksoi se liria e Kosovës nuk është fituar lehtë pa sakrificën e dëshmorëve tanë, të cilët luftuan për një Kosovë të lirë dhe të pavarur. Ne nuk do të kishim institucionet që kemi sot, andaj duhet të punojmë dhe të ndërtojmë vendin tonë në mënyrë që amanetin e të rënëve ta jetësojmë.***



## **Fillojnë dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2025-2027**

**Me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, Komuna e Lipjanit ka filluar sot dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.**

**Takimet e para janë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe komiteteve të tjera. Më pas, diskutimet kanë vazhduar me përfaqësuesit e Shoqatave të Grave, Shoqërisë Civile, Personave me Aftësi të Kufizuara, Shoqatave të Rinjve, Klubeve Sportive, Fermerëve dhe banorëve të qytetit të Lipjanit.**

**Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, ka theksuar se qarkorja e parë buxhetore përcakton kufijtë fillestarë për përgatitjen e planifikimit të shpenzimeve për KAB për periudhën 2025-2027. Kufijtë përfundimtarë do të përcaktohen në qarkoren e dytë buxhetore, bazuar në nevojat e drejtorive dhe prioritetet e qytetarëve, të cilat do të adresohen gjatë dëgjimeve publike. Gjatë takimeve të sotme, u trajtuan çështje të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me nevojat e qytetarëve të Lipjanit.**



***Takimet e dëgjimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2025-2027 kanë vazhduar edhe në fshatin Sllovi, me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.***

***Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, prezantoi buxhetin e Komunës së Lipjanit para qytetarëve të Sllovis, duke u bërë thirrje atyre që të parashetrojnë kërkesat e tyre për t'u përfshirë në planifikimin e buxhetit komunal.***

***Gjatë këtij takimi, qytetarët e Sllovis shprehën kërkesat e tyre, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me nevojat specifike të fshatit Sllovi.***



## ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka organizuar diskutim publik për Hartimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.***

*Me këtë rast Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, theksoi angazhimin e komunës për të zhvilluar shërbime që adresojnë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara.*

*"Dokumente të tilla synojnë gjithmonë harmonizimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve, komunitetit lokal dhe organizatave joqeveritare, për të siguruar që çdo veprim të jetë drejtpërdrejt i lidhur me nevojat e personave me aftësi të kufizuara," ka thënë Nënkryetari Bytyqi.*

*Ai vlerësoi gjithashtu përkushtimin e Kryetarit Imri Ahmeti për përfshirjen dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës publike. Në qytetin e Lipjanit infrastruktura është përmirësuar ndjeshëm, duke ndërtuar pjerrinat e nevojshme që lehtësojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara deri te shërbimet institucionale.*





***Po vazhdojnë dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2025-2027, me qëllim të përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në planifikimin buxhetor.***

***Komuna e Lipjanit ka vazhduar mbajtjen e dëgjimeve për planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 me banorët e fshatrave Dobrajë e Madhe dhe Krojmir.***

***Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, para të pranishmëve fillimisht ka prezantuar buxhetin e Komunës së Lipjanit dhe pastaj ka hapur diskutimin me qytetarët pjesëmarrës për t'u njohur për së afërmi me kërkesat dhe prioritetet konkrete të qytetarëve të këtyre fshatrave, në mënyrë që ato të përfshihen në planifikimet buxhetore.***

***Takimet për dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore vazhdojnë edhe nesër në fshatin Grackë e Vjetër.***



## ***Mbahet edicioni i tretë i panairit P-GJASHT në Lipjan***

*Me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, në shënimin e Ditës së Shkollës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” u mbajt edicioni i tretë i panairit tradicional të Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë (P-GJASHT).*

*Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, deklaroi se panairë të tilla meritojnë mbështetje institucionale.*

*“Mbështetja e aktiviteteve si P-GJASHT është një investim i vlefshëm në të ardhmen e fëmijëve tanë dhe në zhvillimin e komunitetit tonë, duke i nxitur ata të jenë më aktivë dhe kërkues për përvoja të reja,” ka thënë kryetari Ahmeti.*



***Me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Komunës së Lipjanit, kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule pranë bustit të komandantit legjendar “Adem Jashari”.***

***Kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë historike të kësaj dite për qytetaret e Lipjanit dhe gjithë kombin shqiptar.***

***"Sot përulemi me respekt dhe mirënjohje të thellë për të gjithë dëshmorët dhe heronjtë tanë të cilët sakrifkuan jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Neve na mbetet që të punojmë fort për ta ndërtuar vendin tonë për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë," ka thënë kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti.***

***Ai shprehu mirënjohje të thellë për të gjithë ata që luftuan dhe sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.***



## ***Me aktivitete të shumta u shënua 25-vjetori i Çlirimit të Komunës së Lipjanit***

***Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, në Qendrën e Kulturës "Tahir Sinani" u organizua Akademia Solemne në nderim të 25-vjetorit të Çlirimit të Komunës së Lipjanit.***

***Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e kësaj dite të veçantë, e cila shënon një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e qytetit të Lipjanit.***

***"Për qytetarët e Lipjanit, 12 Qershori 1999 mbetet dita më e madhe, më e lumtur dhe e paharruar. Kjo nuk është një datë e zakonshme kalendarike, por një ngjarje e rëndësishme ndër vitet e ekzistencës popullore përtej kufirit të shtetit amë," ka thënë kryetari Ahmeti.***



## **Koncert Festiv për nder të 25-vjetorit të çlirimit të Komunës së Lipjanit**

*Mbrëmjen e përmbyllëm me Koncertin Festiv për të shënuar 25-vjetorin e Çlirimit të Komunës së Lipjanit. Me një atmosferë festive e cila u krijua nga këngëtari lipjanas Hanefi Murati dhe këngëtari i mirënjohur Asim Gashi, i cili publikut lipjanas i dhuroi emocione të veçanta me interpretimin e këngëve që e bënë madhështore festën e 25-vjetorit të çlirimit.*

*Urime Dita e Çlirimit, Lipjan!*



***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në hapjen e ekspozitës në bibliotekën e qytetit nga fotografi i njohur Arian Mavriqi, i mbështetur nga Komuna e Lipjanit.***

***Hapja e kësaj ekspozite me peizazhe të mrekullueshme të Kosovës, të cilat shpërfaqin dhe zbulojnë thesaret natyrore të Kosovës, ishte pjesë e aktiviteteve të 12 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit.***



## **Mbahet Seancë Solemne në shënim të 14 qershorit, Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit**

*Shënimin e kësaj dite përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit të prirë nga Kryetari z. Imri Ahmeti, e nisën me homazhe dhe nderime te shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari në sheshin e qytetit të Lipjanit. Më pas vazhduan me seancën solemne në sallën e Kuvendit të Komunës.*

*Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, në një fjalë rasti para të pranishmëve theksoi rëndësinë e kësaj dite në kalendarin e ngjarjeve të komunës, duke kujtuar dhe nderuar sakrificën sublime të dëshmorëve dhe martirëve.*

*“Është detyrë e jona të kujtojmë dhe të nderojmë sakrificën e dëshmorëve, sepse ata na lanë trashëgiminë e çmuar të lirisë së vendit tonë. Këtë trashëgimi jemi të detyruar ta ruajmë dhe ta transmetojmë me krenari dhe përgjegjësi tek gjeneratat e reja,” ka thënë kryetari Ahmeti.*



## ***Me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, në Grykën e Shalës u realizua aktiviteti "Kujtesa Kolektive e Luftës së viteve 1998-1999".***

*Në këtë aktivitet për nder të 14 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve, mori pjesë kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë, theksoj se kujtesa kolektive është themeli mbi të cilin ndërtohet identiteti dhe e ardhmja e kombit.*

*"Kujtesa kolektive është më shumë se një mbamendje e së kaluarës ajo është një angazhim që ne i bëjmë vetes dhe brezave të ardhshëm për të mos harruar kurrë atë që ka ndodhur në Kosovë. Ky aktivitet na fuqizon dhe na përkujton momentet të cilat i kemi kaluar si shoqëri dhe të cilat asesi nuk duhet të harrojmë sakrificën e atyre që dhanë jetën për lirinë tonë dhe për përgjegjësinë që kemi për të ndërtuar një të ardhme më të ndritur për vendin tonë," ka thënë kryetari Ahmeti.*





***Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkëpunëtorë dhe anëtarët e Këshillit organizativ të turneut “Ibrahim Krasniqi” kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule pranë varrit të Dëshmorit Ibrahim Krasniqi në Smalleshë, në kujtim të jetës dhe veprës së tij.***

***Lavdi!***



***Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, në emër të institucioneve komunale, ju uron të gjithë qytetarëve të Lipjanit festën e Kurban Bajramit!***

***Të nderuar qytetarë,***

***Në këtë ditë të veçantë të Kurban Bajramit, dëshiroj t'ju uroj gëzim, paqe dhe begati. Le të jetë kjo festë një mundësi për të reflektuar mbi vlerat e sakrificës, dashurisë dhe solidaritetit që na bashkon.***

***Le të festojmë së bashku me familjarë e miq.***

***Gëzuar Kurban Bajramin!***

***I.A***



***Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, u mbajt sesion informues nga Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK) me mbështetje nga DRC lidhur me projektin “Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”, ky projekt do të zbatohet në Komunën e Lipjanit dhe do të mbështesë komunitetin RAE (rom, ashkali dhe egjiptian) dhe grupet e tjera joshumicë.***

***Nënkryetari për Komunitete në Komunën e Lipjanit z.Lulzim Qerimi dhe drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural z. Rexhep Rexhepi së bashku me përfaqësuesit e projektit kanë dhënë informata të detajuara rreth aktiviteteve të projektit dhe mundësive të aplikimit.***

***Projekti ofron grante, trajnime praktike në fushën e bujqësisë, punësim në marrëveshje me kompani të ndryshme dhe trajnime për të optimizuar performancën në vendin e punës.***



***Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me kryesuesin e Kuvendit z. Daut Azemi, kanë pritur në takim anëtarin e Bordit të “Astronomy Outreach of Kosova”, z. Bujar Mehmeti, i cili i njoftoi rreth ceremonisë solemne të hapjes së Observatorit dhe Planetariumit Kombëtar të Republikës së Kosovës.***

***Bujar Mehmeti është një i ri me shumë potencial nga Babushë i Lipjanit, i cili ka përfunduar studimet në Hungari dhe aktualisht është kandidat për doktoraturë në Fizikë Mjekësore në Universitetin e Wisconsin-Madison, SHBA. Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti, e ka nderuar me mirënjohje për arritjet e tij të larta akademike.***



**Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, ka pritur në takim Ministrin e Mbrojtjes të FSK-së z. Ejup Maqedonci.**

**Kryetari Ahmeti fillimisht falënderoi ministrin për vizitën në Komunën e Lipjanit dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në të gjitha fushat ku Ministria e Mbrojtjes ka nevojë.**

**"Sigurisht që është e nevojshme të krijohen plane të tilla të cilat ndihmojnë në reagimin ndaj situatave emergjente dhe të sigurisë, andaj ne si institucion jemi të hapur për të bashkëpunuar në çdo iniciativë apo koncept që ka për qëllim përmirësimin dhe aftësimin për të vepruar në situata emergjente apo të jashtëzakonshme," tha kryetari Ahmeti.**



**Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim klubin e volejbollit Skënderbeu, të cilët janë shpallur Kampionë të Volejbollit në Kosovë për grupmoshat U-14 dhe U-16.**

*Kryetari Ahmeti u shpreh i lumtur për suksesin e arritur në garat e volejbollit si klub e po ashtu edhe në garat shkollore, duke theksuar rëndësinë e këtij suksesi për qytetarët e Lipjanit.*

*"Lipjani është me fat që ka një rini kaq të shëndetshme dhe aktive në sport, çdo sukses i çdo ekipi jo vetëm që na bën krenar neve si institucione, por me këtë krenohen gjithë lipjanasit. Lipjani tashmë është një prej qyteteve që konkurron me qytetet e mëdha në të gjitha fushat sportive dhe kjo më gëzon shumë që të rinjtë tanë po angazhohen në aktivitete sportive dhe po korrin vazhdimisht suksese," tha Kryetari Ahmeti, duke u shprehur që çdo ekip që i sjell Lipjanit suksese të tilla do ta ketë mbështetjen institucionale.*

*Përfaqësuesit e KV Skënderbeut falënderuan Kryetarin Ahmeti për mbështetjen e vazhdueshme dhe prezantuan trofetë me të cilët janë shpallur Kampionë të Volejbollit në Kosovë për grupmoshat U-14 dhe U-16.*




## **Kryetari Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë**

*Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal ka mbajtur takim publik me qytetarë, të cilët i ka njoftuar për punën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2024 të qeverisjes lokale ku bashkërisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.*

*Kryetari Imri Ahmeti është shprehur i kënaqur me dinamikën e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku aktualisht janë duke u zhvilluar në teren 44 projekte investime vetanake nga komuna dhe projekte të tjera së bashku me partner. Gjithashtu Kryetari Ahmeti tha se projekte të shumta kapitale janë proces të publikimi, vlerësimit dhe lidhjes së kontratave dhe shumë shpejtë do të fillojë implementimi i tyre.*

*Po ashtu, Kryetari Ahmeti, ka potencuar se të hyrat e përgjithshme vetanake deri në fund të muajit maj ka arritur të realizohet mbi 53.44 % me theks të veçantë ka përmendur të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë që deri më tani është realizuar 42.61% nga planifikimi për vitin 2024.*



## **Vendosen 35 kamera të sigurisë në Magurë**

*Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e këtij projekti për qytetarët e Magurës, i cili do të ndikojë në rritjen e sigurisë.*

*"Vendosja e kamerave të sigurisë në Magurë është një hap i domosdoshëm për të siguruar një mjedis më të sigurt për banorët. Kjo iniciativë do të ndihmojë në parandalimin e veprave të kundërligjshme dhe njëherësh do të ketë impakt në rritjen e sigurisë," tha Kryetari Ahmeti.*

*Kamerat e sigurisë janë instaluar në pikat kyçe, duke përfshirë hyrjet dhe daljet kryesore, zonat publike, si dhe afër objekteve institucionale.*

*Përfaqësuesit e organizatës Center for Education and Development of Environment (CEDE) e kanë falënderuar Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin e ofruar në realizimin e këtij projekti dhe projekteve të tjera që do të realizohen në Magurë.*

*Ndërsa stacioni i Policisë së Kosovës në Magurë do të ketë qasje të drejtpërdrejtë në pamjet e kamerave për të monitoruar situatën.*





***Drejtori i Infrastrukturës z. Sead Aliu me bashkëpunëtorët e tij nga afër kanë përcjell punimet përfundimtare të rrugës Bashkim Krasniqi në qytetin e Lipjanit e cila lidh rrugën Haradin Bajrami me rrugën Haxhi Kleçka.***

***Përveq asfaltimit të kësaj rruge punimet finale janë duke u zhvilluar edhe me rregullimin e infrastrukturës përcjellëse si: ndriçimin publik, trotuarin, drunjte dekorativ si dhe sinjalizimin rrugor.***



## ***KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 27-të me radhë***

***Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 27-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.***

***Pas prezantimeve dhe diskutimeve për secilën pikë, anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të premtën, më 28 qershor 2024.***



## ***Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 27-të me radhë***

***Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit, është mbajtur mbledhja e 27-të e Komitetit për Komunitete (KK), udhëhequr nga kryesuesi i komitetit z. Skender Bikliqi, ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.***

***Gjatë kësaj mbledhjeje zyrtari kryesor financiar ka dhënë informata lidhur me kornizën buxhetore të komunës së Lipjanit. Në të njëjtën kohë, anëtarët e KK-së shqyrtuan çështje të ndryshme që prekin komunitetet që jetojnë në komunën e Lipjanit.***




## ***Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka aprovuar Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027***

***Gjatë ditës së sotme, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi z. Daut Azemi, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 31-të me radhë, në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat ishin të propozuara për këtë seancë.***

***Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.***

# Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë